

Benvenuto in Banca



Benvenuto in banca:

possiamo aiutarla a vivere e lavorare meglio in Italia

Bienvenue a la banque :

nous pouvons vous aider a mieux vivre et travailler en Italie

مرحبا بكم في البنك:

نستطيع أن نساعدكم لكي تعيشوا وتعملوا على نحو أفضل في إيطاليا

Mirëserdhët në bankë:

ne mund t'ju ndihmojë të jetojini dhe te punoni më mirë në Itali

Welcome to the bank:

we can help you live and work better in Italy

欢迎进入银行:

我们可令您在意大利的生活与工作更加轻松

*Benvenuto in Banca
è realizzato da*



in collaborazione con

ACLI, ANCI, ARCI, CARITAS ITALIANA, CeSPI, CISS e UNHCR.



Progetto grafico



www.etnocom.com

© Bancaria Editrice - Giugno 2011
Stampato da Spadamedia S.r.l., Roma
ISBN 978-88-449-0869-0

INDICE



**PER COMINCIARE
STRUMENTI E SERVIZI BANCARI, DALLA A ALLA Z**

**5
10**



**POUR COMMENCER
OUTILS ET SERVICES BANCAIRES**

**21
26**



**لكي نبدأ
أدوات وخدمات بنكية**

**37
42**



**PËR TË FILLUAR
MJETET DHE SHËRBIMET BANKARE**

**53
58**



**GETTING STARTED
BANKING PRODUCTS AND SERVICES**

**69
74**



**从这里开始
银行工具与服务**

**85
90**



ABI, në bashkëpunim me ACLI, ANCI, ARCI, CARITAS ITALIANA, CeSPI, CISS

MIRËSERDHËT NË BANKË: NE MUND T'JU NDIHMOJMË TË JETONI DHE TË PUNONI MË MIRË NË ITALI

ABI, shoqata që bashkon bankat italiane, ia dedikon këtë broshurë qytetarëve të huaj që jetojnë dhe punojnë në vendin tonë. Të njohësh se ç'mund të bëjë një bankë për ty, për aktivitetin dhe familjen tuaj do t'ju lejojë të keni një jetë më të thjeshtë dhe të bëni projekte për të ardhmen tuaj.

Në faqet në vazhdim do të gjeni shumë përgjigje të pyetjeve tuaja, për shembull:

- Si mund t'i dërgoj para familjarëve në vendin tim?
- Punëdhënësi më ka kërkuar të hap një llogari rrjedhëse për derdhjen e rrogës. Çfarë dokumentesh më duhen?
- Si ta paguaj qiranë, faturat dhe taksat?
- Do të doja të blija një shtëpi në Itali. A mund ta bëj? Mund të kem një hua? Të ardhurat e mia a janë të mjaftueshme?
- Do të doja të lija mënjatë kursimet e mia për të ardhmen time dhe të fëmijëve të mi. Çfarë zgjidhjesh ka?
- Do të doja të isha i mbrojtur nëse më ndodh një e papritur mua apo familjes time. Si mund ta bëj këtë?

Për të dhënë shembuj të shërbimeve të bankave që janë më të dobishme për ju, kemi punuar me organizata të ndryshme që çdo ditë janë në kontakt me qytetarët e huaj: Acli, Anci, Arci, Caritas Italiana, Centro Studi di Politica Internazionale, Cooperazione Internazionale Sud Sud. Bashkëpunimi i UNHCR-së, i Komisarariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët - ka lejuar të zgjerohet këtë broshurë edhe për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare (refugjatë dhe titullarë të mbrojtjes).

Tani, hyjmë së bashku në bankë.

PËR TË FILLUAR

Për të pasur shërbime nga një bankë, ju mund të hapni një llogari rrjedhëse ose një llogari kursimi. Nëse akoma nuk e dini se çfarë janë, jua shpjegojmë në faqen 63 dhe 64.

Nëse dëshironi të keni informacione, mund:

- të shkoni në cilëndo bankë dhe të pyesni te sporteli; në disa raste mund të gjeni edhe dokumente dhe shpjegime në gjuhën tuaj
- të konsultoheni në faqen e internetit të bankës
- të telefononi, nëse banka ka një qendër telefonatash dhe një numër jeshil.

Në faqen e internetit www.pattichiari.it mund të krahasoni kostot e llogarive rrjedhëse të bankave që kanë këtë lloj sipërmarrjeje.

Për ligjin italian, kush dëshiron që të hapë një llogari rrjedhëse duhet të paraqesë



dokumentet e tij të identitetit: kartën e identitetit ose pasaportën e vlefshme si dhe numrin e sigurimeve. **Qytetarët e huaj** duhet të paraqesin pasaportën ose kartën e identitetit dhe lejen e qëndrimit të vlefshme.

BËNI KUJDES me kohëzgjatjen e lejes së qëndrimit, edhe në varësi të llojit të kontratës së punës, si dhe me kohën e nevojshme për të kërkuar rinovimin.

Përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare duhet të paraqesin kartën e identitetit ose dokumentin e udhëtimit, zëvendësues i pasaportës, dhe lejen e qëndrimit që ka vlefshmëri prej 5 vjetësh për refugjatët dhe 3 vjet për titullarin e mbrojtjes. Për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare, leja e qëndrimit është e rinovueshme edhe në qoftë se ju nuk keni një marrëdhënie punësimi. Për pjesën më të madhe të shërbimeve bankare parashikohet një kontratë, e shkruar në italisht, që duhet të jetë e firmosur.

Shërbimet nëpërmjet internetit ose telefonit

Nëse e ke tashmë një llogari rrjedhëse, me shërbimet e internetit bankar dhe me telefon mund të kërkonit sa para keni në llogari në atë moment dhe lëvizjet e parave që keni kryer, si dhe mund të bëni transferta të parave. Në shumë raste, mund të rimbushni celularin dhe kartat me parapagesë. Telefonata në numrin jeshil është falas. Disa qendra telefonike bankare kanë persona që flasin edhe gjuhën tuaj. Sa kushton interneti bankar? Zakonisht shërbimet kushtojnë më pak sesa shërbimet në sportel. Nëse doni të përdorni bankën me internet apo me telefon, kini parasysh që duhet të firmosni një kontratë dhe të ndiqni disa rregulla të thjeshta.

VINI RE: Ruani me kujdes kodet e hyrjes që ju jep banka për të punuar në distancë (emri i përdoruesit, fjalëkalimi, PIN-i). Nuk duhet t'ia jepni askujt. Mbani mend që banka mund t'ju kontaktojë me telefon, me e-mail ose me një mesazh, por nuk do t'ju kërkojë kurrë kodin e hyrjes. Nëse dikush ju kërkon duke ju thënë se është nga banka juaj, është me siguri një mashtrim.

- Shkruani dhe mbani gjithmonë me vete numrat e telefonit të bankës dhe mbi të gjitha numrin jeshil të qendrës së thirrjeve.
- Shkruani direkt adresën e bankës në shiritin e kërkimit të shfletuesit (d.m.th aty ku është www.) dhe mos shtypni asnjëherë në lidhjet e email-ve të marra edhe pse duket sikur janë dërguar nga banka juaj.
- Kontrolloni llogaritë e tërhequra - dokumentet me lëvizjet e llogarisë suaj - që merrni rregullisht nga banka. Nëse gjeni veprime që nuk i keni kryer, kontaktoni menjëherë qendrën e thirrjeve të bankës ose shkoni direkt në sportel.



TË DËRGOSH PARA NË SHTËPI - Transferimet e parave nëpërmjet bankës janë të sigurta!

ÇFARË JU DUHET?	ÇFARË JU OFRON BANKA?
Të dërgosh para në vendin e origjinës	Transfertë Bankare 61 Kartë e parapaguar 62 Remitanca (Dërgim parash) 68

TË MENAXHONI PARATË TUAJA DHE TË KRYENI PAGESAT - Bëni kujdes në lëshimin e një çeku "bosh", pra pa pasur të holla në dispozicion në llogari, ky është një veprim në kundërshtim me ligjin.

ÇFARË JU DUHET?	ÇFARË JU OFRON BANKA?
Depozitimi i parave	Kartë krediti 61 Llogaria rrjedhëse 63 Llogari kursimesh 64 Shërbime bankare bazë 68
Tërheqja e parave	Bankomat ATM 60 Kartë krediti 61 Kartë parapaguar 62
Hedhja e pagave në llogarinë bankare	Kartë parapaguar 62 Llogari rrjedhëse 63 Shërbime bankare bazë 68
Pagesa e qirasë dhe faturave	Çek bankar 58 Bankomat ATM 60 Transfertë Bankare 61 Kartë krediti 61 Kartë parapaguar 62 RID (pagesë automatikisht në llogarinë bankare) 67
Blerja dhe pagesat pa para në dorë edhe me këste (në rastin e kartës së kreditit)	Çek bankar 58 Bankomat ATM 60 Transfertë Bankare 61 Kartë krediti 61
Blerjet dhe pagesat në internet	Transfertë Bankare 61 Kartë krediti 61 Kartë parapaguar 62
Pagimi i taksave	Modeli F24 64



MARRJA E NJË KREDIE - Banka nuk jep automatikisht një kredi për këdo që e kërkon. Para se të japë një kartë krediti, kredi, hua për hipotekë, banka bën një vlerësim të kreditit, pra nëse klienti ka mundësinë e kthimit të parave në kohë. Sa më shumë që e njeh banka personin që kërkon kredinë, aq më shumë informacion ka për të vlerësuar klientin dhe aq më shumë është e mundur që banka t'ju japë kredinë e parave. Nëse konsumatori ka lëshuar një çek, pa pasur të holla në dispozicion, do të jetë shumë e vështirë për të marrë një kredi. Para se të aplikoni për një kredi, që në çdo rast kushton, është e nevojshme të verifikohet nëse me rrogën e tij klienti do të jetë në gjendje të paguajë paratë pak nga pak, duke paguar edhe një kosto për shërbimin. Kostoja e kredisë e shprehur në përqindje, është quajtur Norma e Përqindjes Vjetore (TAEG). Për disa kredi, është e detyrueshme të siguroni:

- me një "police të sigurimit të jetës dhe mbrojtjes ndaj rrezikut në punë" për të përfutur kredinë "dhënia e një të pestës së pagës apo pensionit
- me një "police kundër dëmeve" për mbulimin e ndodhive të zjarrit dhe shpërthimeve për të marrë një kredi.

ÇFARË JU DUHET?	ÇFARË JU OFRON BANKA?
Të blini shtëpi	Kredi për hipotekën 65
Të paguani për shpenzime të papritura	Dhënie të një të pestës së pagës ose pensionit 63 Kredi personale 67
Të blini telefon celular, TV, elektro-shtëpiake, motoçikleta, makina	Qëllimi i kredisë 66
Të nisni një aktivitet të pavarur apo një biznes	Kredi për biznesin 67

KUJDES NGA FAJDET

Mos u drejtoni te personat e gabuar që ju premtojnë ndihmë financiare, sepse ka rrezik që të bini në rrjetin e fajdeve. Të marrësh fajde është një krim në Itali. Dhënia e fajdeve konsiston në dhënien e kredisë me interesa të paligjshme dhe aq të lartë sa që e bën rimbursimin e saj shumë të vështirë ose të pamundur. Personi, i cili bie viktimë e fajdeve është i detyruar të kërkojë kredi të tjera, edhe këto me normat e fajdeve dhe hyn në borxh gjithmonë e më shumë. Të marrësh fajde është shpesh një rrugë pa dalje. Nëse ndodhni tashmë në këtë situatë mund të kontaktoni me fondacionet kundër fajdeve, organizatat vullnetare, famullitë, degët lokale kundër fajdeve, shoqatave tregtare, sindikatave dhe shoqatave të mbrojtjes së konsumatorit; këto mund t'ju ndihmojnë kundër fajdeve, madje edhe për të denoncuar veprimtarinë e fajdeve tek autoritetet përkatëse. Në qoftë se jeni në vështirësi dhe rrezikoni të bëheni pjesë e fajdeve, qoftë privatisht apo si biznes, mund të siguroni kredinë e kërkuar në bankë nëpërmjet fondeve për parandalimin e fajdeve.

Për të përfutur këto fonde mund ti drejtoheni bankës tuaj për të kontaktuar:

- me Konfederatën, në qoftë se jeni një sipërmarrës i vogël (zejtar, tregtar, etj.)
- me Fondacionet kundër fajdeve, nëse problemi është vetëm për ju ose familjen tuaj.

Lista e Shoqatave, Fondacioneve kundër fajdeve dhe të Konfederatave, është në dispozicion në faqen e internetit http://www.dt.tesoro.it/export/sites/sitodt/modules/documenti_it/prevenzione_reati_finanziari/antiusura/Elenco_associazioni_e_fondazioni.pdf

MENAXHIMI I KURSIMEVE DHE PËRBALLIMI I NGJARJEVE TË PAPRITURA - Nëse ju doni të vendosni disa para mënjane për të grumbulluar kursimet dhe të përballoni ngjarjet e paparashikuara, mund të gjenden shumë zgjidhje në bankë. Kërkoni këshillë në sportel për të kuptuar se cila është mënyra më e mirë për të kursyer sipas nevojave tuaja dhe të familjes tuaj dhe cilat lloje të sigurimit janë të përshtatshme për ju. Kursimet mund të investohen në mënyra të ndryshme. Nëse fitimi është më i lartë, në përgjithësi ka më shumë rrezik. Nëse investimi ka qenë pozitiv, do të ketë më shumë para që investohen në një fitim (kthim pozitiv), por nëse ka qenë negativ ju do të rimarrni më pak para se ato që kishit paguar.

ÇFARË JU DUHET?	ÇFARË JU OFRON BANKA?
Të vini mënjane të holla për veten tuaj dhe për të ardhmen e fëmijëve tuaj dhe të bësh investime të vogla	Llogari depozite 64 Llogari kursimesh 64 Plan akumulimi 66
Të përballoni ngjarje të rënda, të tilla si vdekja	Sigurim të jetës 60
Të përfitoni një rimbursim të shpenzimeve shëndetësore ose të përballoni një sëmundje	Siguracioni shëndetësor 59
Të merrni një rimbursim të shpenzimeve në qoftë se vuani ose ju shkaktojnë dëme, në makinë apo në punë dhe në jetën private; të mbrojnë shtëpinë tuaj dhe gjithçka brenda saj nga vjedhje/zjarre të mundshme	Siguracion dëmtimi 59
Të merrni një rimbursim në qoftë se lëndoheni dhe nuk mund të punoni për një periudhë të caktuar	Siguracion fatkeqësish 59
Të merrni një pension më të lartë	Pension plotësues 66

Në faqet e ardhshme do të gjeni shërbimet kryesore që bankat u ofrojnë atyre, avantazhet e tyre dhe gjithashtu gjërat (përveçse letrat me vlerë), për të cilat duhet të jeni të kujdesshëm.



MJETET DHE SHËRBIMET BANKARE

Çek bankar

Me çekun bankar i kërkojmë bankës tonë të paguajë një person apo kompani tjetër. Për të përdorur çeket ju duhet të keni një llogari rrjedhëse, nga e cila do të merren paratë.

PËR INFORMACION: Lëshimi i bllokut të çeqeve nuk është automatik: banka duhet të bëjë më parë një vlerësim të kreditit të klientit. Është e rëndësishme të dini se në qoftë se plotësohet një çek për të paguar dikë, të jeni të sigurt që ato para të jenë në llogarinë rrjedhëse. Të bësh një çek “bosh”, d.m.th pa pasur paratë në dispozicion në llogari, është kundër ligjit dhe ka pasoja të rënda: do të ketë sanksione dhe nëse në të ardhmen do të kërkonte një financim apo një kartë krediti, do të jetë shumë e vështirë për t'i marrë. Bëni kujdes edhe me çeket që ju japin për të kryer pagesat: për tu siguruar që paratë t'ju jepen, do të duhet të prisni kohën teknike të nevojshme për të verifikuar që çeku nuk është “bosh”, ky proces është quajtur “subjekt i suksesshëm”.

Çeku është i vlefshëm dhe banka mund ta paguajë atë, vetëm nëse në të janë shkruar: vendi dhe data e lëshimit, shuma për t'u paguar (në shifra dhe germa italiane), emri dhe mbiemri i atij që do të marrë pagesën dhe nënshkrimi i dërguesit të çekut.

Nëse personi i cili merr çekun ka një llogari bankare rrjedhëse, mund ta kalojë atë në llogarinë e tij. Nëse nuk e ka një të tillë, mund t'i derdhë të hollat në agjencinë e bankës, të specifikuar te çeku, por duhet të ketë me vete kartë identiteti ose pasaportë ose dokumentin e udhëtimit për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare.

VINI RE: mund t'ju kërkojnë dy dokumente identiteti.

Në qoftë se çeku është paraqitur në të njëjtin qytet ku ndodhet dega e bankës që e paguan (shkruar në vulë mbi çek), ka 8 ditë për të bërë derdhjen. Në qoftë se paraqitet në një qytet të ndryshëm, do të jenë 15 ditë. Sa kushtojnë çeket? Varet nga banka dhe nga lloji i llogarisë bankare të zgjedhur. Mund të kenë kosto si blloqet e çeqeve ashtu edhe transaksionet individuale.

Çek me firmën e arkëtarit

Përveç çekut bankar ekziston edhe një lloj tjetër çeku: çek me firmën e arkëtarit.

Çeku bankar me firmën e arkëtarit është më i sigurt sesa një çek bankar, sepse lëshohet nga një bankë dhe është e sigurt se paratë e paraqitura janë tashmë në dispozicion. Nëse dikush ka për të paguar me një çek me firmën e arkëtarit, mjafton të shkojë te sporteli i një banke. Nëse ju keni një llogari rrjedhëse në atë bankë, shuma dhe kostoja e çekut do të mbahen nga llogaria juaj bankare; përndryshe duhet të derdhni shumën totale me para në dorë sipas kërkesës.

Sa kushton të bësh një çek me firmën e arkëtarit? Varet nga banka.



Çeku me firmën e arkëtarit është i vlefshëm vetëm nëse përmban shkrimin “çek me firmën e arkëtarit”, emrin dhe mbiemrin e atij që merr pagesën (përfituesi), datën dhe vendin e lëshimit dhe emrin e bankës që e lëshon. Përfituesi, i cili merr çekun me firmën e arkëtarit, duhet të paraqesë çekun për derdhje brenda 30 ditëve nga data e lëshimit pranë çdo sporteli të bankës që e lëshon. Në mënyrë që të merrni të hollat duhet të shkoni pranë bankës së treguar në çek dhe të sillni me vete kartën e identitetit ose pasaportën, ose dokumentin e udhëtimit për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare.

VINI RE: mund t’ju kërkohen dy dokumente identiteti.

Sigurimi nga dëmet dhe fatkeqësitë

Duke paguar një shumë të caktuar parash të quajtur këst (kostoja që paguhet për një sigurim të caktuar), sigurimi nga dëmtimet lejon të merrni rimbursimin e shpenzimeve të kryera qoftë kur i siguruari pëson dëmtimin e makinës, të shtëpisë apo është dëmtuar gjatë punës, apo kur pa dashje mund t’u shkaktojë dëme personave të tjerë apo për prona të ndryshme.

Për çdo lloj dëmtimi ka një sigurim të veçantë:

- për djegien e makinës, të shtëpisë apo dyqanit
- për aksidentet, në qoftë se lëndohemi gjatë ushtrimit të aktivitetit të punës
- për Përgjegjësinë Civile, në qoftë se dëmtojmë pa dashje persona të tjerë apo prona të ndryshme
- për Përgjegjësinë Civile të Makinave (RCA), në qoftë se padashur provokojmë dëme të personave apo pronës në një aksident me makinë, kur jemi duke ngarë një automjet: policia është e detyruar të kërkojë në bazë të ligjit
- mbrojtjen gjyqësore ose mbrojtjen ligjore, në qoftë se e kemi të nevojshme të na lexohen të drejtat tona dhe kemi nevojë për ndihmën e një avokati apo të një eksperti
- të udhëtimit, në qoftë se na ndodhin aksidente, fatkeqësi apo vjedhje gjatë një udhëtimi, apo nëse shkojmë në një vend ku kujdesi shëndetësor është i paguar (për shembull, në SHBA).

Siguracioni shëndetësor

Sigurimi shëndetësor rimbursos shpenzimet mjekësore të të siguarit dhe të familjarëve të tij. Çmimi vjetor i policës së sigurimit, duke përfshirë edhe shtyrjen, varet nga garancitë e sigurimeve të përzgjedhura, pra, për cilat sëmundje apo fatkeqësi është e mundur që të merrni një rimbursim të shpenzimeve dhe deri në çfarë mase dhe nga numri i pjesëtarëve të familjes që mund të sigurojmë. Është e rëndësishme të dini se njerëzit e prekur nga sëmundje të veçanta nuk mund të sigurohen, për shembull pacientët me probleme psikiatrike, të prekur nga SIDA apo me probleme të drogës. Disa banka ofrojnë për qytetarët emigrantë sigurime që garantojnë:

- shpenzimet e udhëtimit të një anëtarit të familjes dhe/ose asistencën për fëmijët e tij, në rastin e shtrimit në spital të të siguarit për shkaqe të rënda



- udhëtimin e kthimit të të siguruarit në vendin e origjinës, në qoftë se vdes një anëtar i afërt i familjes
- në Itali, dërgimin e një mjeku në rast urgjence
- një numër telefoni për informacion në lidhje me kujdesin shëndetësor, apo një këshillim përkatës mjekësor.

Sigurimi i jetës

Sigurimi i jetës është kontrata e sigurimit që ndihmon të siguruarin dhe familjen e tij për të përballuar ngjarje negative apo të papriturat e jetës. Sigurimet “e përkohshme në rast vdekjeje” u sigurojnë përfituesve një kapital (një shumë të madhe parash të marra të gjitha njëherësh) ose një formë pensioni (një sasi të vogël çdo muaj) në rastin e vdekjes së të siguruarit. Disa banka ju ofrojnë sigurim shtetasve të huaj që të rimbursojnë shpenzimet e riadhesimit të trupit në vendin e origjinës, në rastin e vdekjes së të siguruarit. Sigurimet “ngjarje e jetës”, i garantojnë të siguruarit një kapital ose një pension për jetën në fund të kontratës.

Edhe sigurimet e jetës paguhen me derdhjen e parave, në mënyrë periodike apo me një zgjedhje vjetore, në formën e kësteve.

Politikat e sigurimit kur aplikohet për një hua apo një kredi

Nëse keni vendosur të kërkonti një hua apo të nënshkruani një marrëveshje kredie, ka sigurime (polica sigurimi), shpesh të lëshuara nga subjekte të ndryshme, të cilat ofrojnë më shumë siguri. Për shembull, ekziston një lloj sigurimi (mbulim i huasë) që ju jep besimin të vazhdoni të shlyeni borxhin me bankën edhe nëse ndodhin ngjarje shumë të rënda, të tilla si vdekja, një lëndim serioz, humbja e punës.

Bankomat ATM

Për të marrë një kartë ATM (bankomati), ju duhet të hapni një llogari bankare. Në Itali me ATM mund të tërhiqni para nga makina automatike e parave (ATM) dhe të paguani në dyqanet që kanë një pajisje fundore të lidhur pranë kasës, nëse ATM-ja ka të shkruar termin Pagobancomat. Nëse karta është e lidhur me rrjetet ndërkombëtare si Visa Electron, Cirrus, Maestro, mund të paguani për blerjet e kryera edhe në dyqane jashtë vendit.

Në ATM mund të kontrolloni balancat dhe transaksionet e llogarisë rrjedhëse, të rimbushni telefonin, të depozitoni, të tërhiqni ose të paguani deri në një shumë maksimale mujore. Kur paguani ose tërhiqni, do t’ju hiqen menjëherë të hollat nga llogaria bankare: për këtë arsye ATM është quajtur një kartë debiti. Për të përdorur ATM, duhet të shkruani kodin sekret me numra të kartës (PIN-in).

VINI RE: Për siguri, mbani gjithmonë të ndarë numrin tuaj PIN nga karta ATM.



Sa kushton? Varet nga banka dhe nga lloji i llogarisë bankare të zgjedhur. Në disa raste, karta ATM ka një kosto vjetore dhe edhe tërheqja e parave nga ATM-të mund të ketë një kosto, sidomos kur tërhiqen paratë nga një degë tjetër banke e ndryshme nga juaja. Në përgjithësi, është më e përshtatshme dhe më e sigurt të paguash direkt me kartë në dyqane, sesa të marrësh paratë nga ATM-të.

Transfertë bankare

Me anë të transferimit bankar mund t'i kërkonit bankës tuaj që të dërgojë para nga llogaria juaj bankare në atë të një personi tjetër ose të një kompanie tjetër (përfituesi). Ju gjithashtu mund të bëni një transferim bankar “me para në dorë”, pra duke sjellë paratë në sportel, por kjo është mirë të bëhet vetëm për sasi të vogla.

Kur bëhet një transferim bankar, duhet t'i jepet bankës emri dhe mbiemri juaj dhe emri, mbiemri dhe kodi IBAN i përfituesit. IBAN (International Bank Account Number) është kodi ndërkombëtar që identifikon llogarinë tuaj bankare. IBAN është i detyrueshëm për të gjitha transferimet brenda vendit si dhe ato të drejtuara në zonën SEPA (Single Euro Payments Area), zona e përbashkët e pagesave në Evropë, në të cilën mund të kryeni dhe të merrni pagesa në euro, me llogarinë tuaj kombëtare, pavarësisht nga vendi evropian në të cilin ndodheni. IBAN nuk është i nevojshëm për transferimet në vende të tjera që nuk përfshihen në SEPA. Me një transferim në Itali ose në zonën e SEPA-s, paratë vijnë në llogarinë rrjedhëse të përfituesit, maksimumi brenda tri ditëve pune; do të bëhen katër ditë në qoftë se për transferimin ju përdorni një formular letre. Sa kushton? Kjo varet, shpenzimet ndryshojnë nga banka në bankë dhe nga lloji i llogarisë së zgjedhur.

Kartë krediti

Për të marrë kartën e kreditit duhet të jeni në moshë madhore dhe të keni një llogari bankare.

PËR INFORMACION: Banka nuk jep automatikisht një kartë krediti për të gjithë ata që e kërkojnë. Më përpara bëhet një vlerësim i kreditit; zakonisht është e nevojshme të ketë një të ardhur që garanton kthimin e parave të shpenzuara me kartë.

Me një kartë krediti mund të bëhen blerje pa të holla në Itali dhe jashtë vendit, nëpërmjet internetit, me telefon dhe në dyqane edhe pse në kohën e blerjes nuk ka para të mjaftueshme në llogari. Për këtë arsye karta është quajtur “kreditit”.

PËR INFORMACION: Paratë do të hiqen nga llogaria, megjithatë, më vonë (zakonisht maksimumi brenda një muaji). Është e rëndësishme të mos harroni të kontrolloni se sa para keni në llogarinë tuaj bankare (bilanci) për të qenë të sigurt se paratë e shpenzuara me kartë krediti mund të rimbursohen (të ngarkohen).



Me një kartë krediti mund të tërhiqni para, si në Itali ashtu edhe jashtë vendit, në degët bankare të lidhura ose në makinat automatike të parave (ATM) që janë pjesë e rrjetit ndërkombëtare.

VINI RE: Për të tërhequr paratë duhet të shkruani një kod sekret (PIN).

Për siguri, mbani gjithmonë të ndarë numrin tuaj PIN nga karta ATM. Tërheqja e parave me një kartë krediti në përgjithësi kushton më shumë se tërheqja me një kartë ATM.

Ekziston një lloj karte krediti të quajtur “rrotullues”, që përdoret në përgjithësi për të paguar me këste blerjet në dyqanet e lidhur me një nga rrjetet ndërkombëtare.

VINI RE: Para se të aktivizoni një kartë krediti rrotullues, lexoni me shumë kujdes të gjitha klauzolat e kontratës, si duhet bërë gjithmonë kur kërkohet një hua.

Sa kushton? Kjo varet nga bankat, nga lloji i kartës dhe llogaria bankare.

Zakonisht karta ka një kosto vjetore dhe procedurat e marrjes së parave mund të kushtojnë shumë, sidomos kur dega nuk është e bankës suaj.

Të bësh blerje me një kartë krediti rrotullues është më shtrenjtë për ju, sepse paguhen edhe interesat mbi këstet. Norma e interesit për paratë e shpenzuara me kartën e kreditit rrotullues është zakonisht më i lartë se me normën me forma të tjera të kreditit.

Kartë e parapaguar

Karta e “parapaguar” është quajtur kështu për shkak se para se të mund të shpenzohen paratë duhet të jenë të kredituara në kartë dhe është ajo që bën rimbushjen herë pas here, duke vendosur për sasinë e caktuar.

Çdo herë që bëni një pagesë ose tërheqje, paratë në kartë ju pakësohen.

Çdo herë që e rimbushni, paratë do të shtohen.

Karta e kreditit është një zgjidhje e mirë për një person të ri që nuk ka një rrogë ose për fëmijët.

Për ta pasur kartën duhet të paraqitni një dokument identiteti dhe lejen e qëndrimit dhe për shumë banka nuk është e nevojshme të keni një llogari bankare.

Me kartën ju mund të tërhiqni cash (para në dorë) në makinat automatike të parave (ATM) dhe të paguani në dyqanet e autorizuar në Itali dhe jashtë vendit nëse kartela është e lidhur me rrjetet ndërkombëtare.

Mund të përdorni kartën për të blerë në internet me më pak rrezik: mashtues të mundshëm mund të vjedhin e shumta aq sa keni në kartë, ndërsa me një kartë krediti, rreziku i humbjes së shumë parave është më i madh.

Për të përdorur kartën e kreditit duhet të shkruani kodin sekret me numra të kartës (PIN).

VINI RE: Për siguri, mbani gjithmonë të ndarë numrin tuaj PIN nga karta e kreditit.



Sa kushton? Kjo varet nga bankat, por zakonisht ju paguani në fillim, për të blerë kartën dhe çdo herë të rimbushjes ose të tërheqjes.

PËR INFORMACION: Nëse ju vjedhin apo ju humbet karta (e kreditit, e debitit, e parapaguar, rrotullues), duhet të informoni menjëherë bankën tuaj apo lëshuesin e kartës dhe të bëni denoncimin tek autoritetet përkatëse. Gjej numrat jeshilë falas për të marrë në telefon në faqen e internetit ose në makinat automatike të parave (ATM-të) e bankës. Telefononi menjëherë për të bllokuar kartën dhe mbrojni kursimet tuaja.

Dhënia e pagave ose pensioneve

Nëse jeni një punonjës i punësuar me kohë të papërcaktuar, një mënyrë për të marrë një kredi nga banka për blerjet tuaja, është dhënia e një të pestës së pagës apo pensionit.

Banka ju jep një kredi personale dhe për të kthyer paratë çdo muaj do të hiqen automatikisht një pjesë e pagës tuaj nga lista e pagave ose nga pensioni mujor, deri në një të pestën (20%).

Llogaria rrjedhëse

Ajo është shërbimi më i rëndësishëm, sepse me llogarinë rrjedhëse janë të lidhur të gjitha shërbimet e tjera bankare. Me llogari rrjedhëse mund të kryhen transaksionet kryesore bankare, të tilla si dhënia dhe marrja e pagesave, marrja e rrogës, marrja e një karte bankomati dhe karte krediti, bërja e një sigurimi, marrja e një kredie, lëshimi i çeqeve, kryerja e transferimeve, pagesa e faturave, menaxhimi i kursimeve tuaja. Llogaria rrjedhëse mund të mbahet dhe përdoret nga një ose më shumë persona ose të mbahet dhe përdoret për një veprimtari biznesi.

Shumë banka italiane ofrojnë llogari rrjedhëse me shërbime shtesë (paketë të llogarive bankare), të hartuara për nevojat e shtetasve të huaj.

Sa kushton? Të hapësh një llogari bankare shpesh është falas, por është një taksë që duhet t'i paguhet shtetit italian prej 34,20 € në vit (taksa e vulës). Ndërsa të përdorësh një llogari bankare, kushton sa të gjitha shërbimet dhe kostoja varet nga lloji i llogarisë që ju zgjidhni dhe si e përdorni atë. Para se të zgjidhni një llogari, mos harroni që ka kosto fikse - si p.sh. tarifa, që është një shumë fikse, zakonisht mujore - dhe me shpenzime të ndryshueshme për operacione të ndryshme. Në faqen e internetit conticorrentiaconfronto.pattichiaro.it mund të krahasoni qetësisht koston e llogarive të ndryshme të ofruara nga bankat italiane që janë pjesëmarrëse në këtë iniciativë. Për ata persona që kanë nevoja bankare bazë - si për shembull, vetëm për të hedhur rrogën e tyre, për të bërë pagesat, për tërheqjen e parave të gatshme në ATM - disa banka ofrojnë një llogari rrjedhëse e quajtur "E thjeshtë", kostoja e të cilës ka një tarifë fikse, që ndryshon nga banka në bankë, por në përgjithësi është shumë e ulët.

Nëpërmjet Treguesit Përmbledhës të Kostos (ISC), mund të keni një numër reference për të ditur sa kushton në një vit një llogari bankare, në bazë të llojeve të ndryshme të përdorimit të llogarisë bankare rrjedhëse.



Së paku një herë në vit, banka ju dërgon në shtëpi pasqyrën e tërheqjeve bankare, një listë kjo, nga e cila mund të kontrolloni të gjitha transaksionet e kryera dhe shpenzimet e llogarisë tuaj rrjedhëse.

Llogari depozite

Llogaria e depozitave është e ndryshme nga llogaria rrjedhëse, sepse ajo është thjesht një depozitë e parave që garanton një sasi përfitimi të ardhurash. Zakonisht, llogaria e depozitave është falas, por ju mund të tërhiqni dhe hidhni paratë, si një lloj “arke kursimi”, ku të depozitoni kursimet tuaja. Sa kushton? Kostoja ndryshon nga banka në bankë, por në përgjithësi është shumë e ulët; edhe përfitimet ndryshojnë nga banka në bankë. Jo të gjitha bankat e ofrojnë këtë lloj shërbimi.

Llogari Kursimesh

Llogaria e kursimit është një mjet për të menaxhuar kursimet tuaja dhe, ashtu si llogaria e depozitës, garanton një sasi përfitimi të ardhurash.

Me llogarinë e kursimeve, vetëm mund të tërhiqni ose të depozitoni para në degën e bankës tuaj dhe asgjë tjetër. Çdo herë që depozitoni apo tërhiqni, transaksioni paraqitet në librezë dhe pranë saj është shkruar se sa para janë ende atje. Sa kushton? Kostoja ndryshon nga banka në bankë.

VINI RE: Mbajeni këtë librezë në një vend të sigurt. Nëse do ta humbni, duhet të kontaktoni menjëherë me bankën tuaj dhe autoritetet gjyqësore për të bërë denocimin. Pas 90 ditësh mund të ketë një tjetër librezë që zëvendëson atë humbur.

Modeli F24

Individët dhe bizneset përdorin modelin e formularit F24 për të paguar taksat (taksat e drejtpërdrejta, TVSH, taksat zëvendësuese), kontributet (p.sh. të sigurimeve shoqërore ose INPDAP apo INPS dhe të përkujdesjes ose INAIL INPS) dhe këstet e sigurimit.

Modeli F24 ka për qëllim të kompensojë të hollat që duhet të paguani me ato që duhet të keni dhe të paguajë diferencën e mbetur në një veprim të vetëm.

Mund të paraqitni modelin e formularit F24 në degën e çdo banke, te një tregtar apo në zyrat e postës. Ose mund ta plotësoni nëpërmjet internetit:

- në faqen e internetit të Zyrës së Taksave (Fisconline për individët dhe Entratel për mbajtësit e TVSH-së); në seksionin e Udhëzuesit të Taksave mund të shkarkoni Udhëzuesin praktik për pagimin e tatimeve
- në faqen e internetit të bankës së tij (banka në shtëpi/bankë në internet për individët dhe Korporatën CBI Bankë Ndër-bankar / banka në distancë për mbajtësit e TVSH)
- në faqen e internetit të Postës Italiane.

Mbajtësit e TVSH (të vetëpunësuar, profesionistë të lirë, zejtarët dhe bizneset) mund të paguajnë vetëm nëpërmjet internetit. Kjo detyrë mund t'i jepet (t'i delegohet) kontabilistit apo pronarit që të paraqesë modelin e formularit të vet F24. Sa kushton shërbimi F24? Ky shërbim është falas.



Kredi për Hipotekën

Kredia për hipotekën është kredi për të blerë një shtëpi.

Ajo shlyhet në intervale të rregullta, zakonisht çdo muaj ose çdo gjashtë muaj, deri në kohën e maturimit. Shuma e kështit mund të jetë e njëjta ose e ndryshme nga koha në kohë, në varësi të llojit të normës së interesit të zgjedhur, që mund të jetë fikse, e ndryshueshme ose një kombinim i të dyjave.

Kohëzgjatja e kredisë për hipotekë është zakonisht ndërmjet 5 dhe 30 vjetëve. Në përgjithësi nuk financohet vlera e plotë e shtëpisë. Ka edhe shpenzime shtesë për hetimin (faza në të cilën banka hap praktikën e financimit dhe fillon verifikimin e kreditimit) dhe ekspertizës (kur merret vlera e plotë e shtëpisë). Mbani në mend se, përveç bankës duhet të paguani edhe noterin.

PËR INFORMACION: Kur ju blini një shtëpi, me ligj duhet të bëhet sigurimi ndaj zjarrit / shpërthimit. Banka që ju jep hua (kredi) mund të ofrojë edhe sigurimin.

Për të aplikuar për një kredi ju duhet:

- të sillni në bankë disa dokumente (kartë identiteti ose pasaportë ose dokument udhëtimi, për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare, numrin e sigurimit social, lejen e qëndrimit)
- të tregojë prej sa vjetësh ka qenë punonjës i një kompanie; numri minimal i kërkuar ndryshon nga banka në bankë në varësi të llojit të kredisë që ju kërkon dhe të llojit të kontratës së punës
- të jepni informacion në lidhje me të ardhurat tuaja nga punësimi apo vetë-punësimi; në shumë raste duhet të paraqiten: modeli Cud (vërtetimi i të ardhurave nga punësimi), listën e pagave të fundit dhe/ose një deklaratë nga punëdhënësi
- të sillni gjithë dokumentacionin e duhur për shtëpinë që doni të blini (akt-marrëveshjen, plan ndërtimin, certifikimin).

VINI RE: Kredia është një angazhim financiar për t'u vlerësuar me shumë kujdes, sepse ajo zgjat në kohë dhe ndikon shumë në shpenzimet e çdo muaji. Shuma e pagesës nuk duhet të kalojë një të tretën e pagës, për të qenë i sigurt që jemi në gjendje të paguajmë shpenzimet e përditshme, faturat dhe shpenzimet e papritura edhe në rast të reduktimeve të mundshme të të ardhura për shkak të një sëmundjeje, aksidenti apo pushimi nga puna. Është e rëndësishme të kujtoni se në qoftë se norma e interesit është e ndryshueshme, norma mund të rritet më shumë.

Termat e kredisë janë të varura nga vlerësimet e bankës dhe aftësia për të shlyer pagesat nga ana e konsumatorit. Kur banka u jep kredi, shtëpia juaj bëhet një garanci për bankën (hipoteka). Normat duhet të paguhet gjithmonë në kohë, përndryshe rrezikoni humbjen e pronësisë së shtëpisë, pa pasur shlyerjen e kësteve tashmë të paguara.

Nëse ju doni të rristrukturoni dhe përmirësoni shtëpinë tuaj, por nuk keni të hollat për të paguar punimet, mund të aplikoni për një kredi në bankë.



Pension plotësues

Siç nënkuptohet nga emri, pension suplementar është projektuar për të rritur sasinë e pensionit në formën e qirasë ose të kapitalit. Pensioni suplementar mund të aktivizohet në mënyrë individuale ose mund të bazohet në një marrëveshje me punëdhënësin: ju të zgjidhni një plan pensioni (fond pensioni të negociuar, fond i hapur pensioni apo plan pensioni individual) dhe qoftë punonjësi qoftë punëdhënësi, paguajnë periodikisht një shumë deri në momentin e daljes në pension.

Plani i akumulimit

Plani i akumulimit lejon që të investohet në një fond të përbashkët edhe për shuma të vogla, për t'u paguar sipas mundësive përkatëse (çdo muaj ose dy, tre ose gjashtë muaj). Fondi i përbashkët është një mjet i investimit kolektiv të kursimeve, të menaxhuara nga kompani të specializuara.

Ju mund të zgjidhni mes llojeve të ndryshme të fondeve: ato ku mund të fitohet më shumë janë edhe më të rrezikshmet. Kontrata e planit të grumbullimit, zakonisht zgjat 5 ose 6 vjet, por në qoftë se në një farë pike ju nuk keni më para për të vënë mënjane apo keni papritmas nevojë për të holla, ju mund të ndaloni pagesat në çdo kohë dhe të rimerri përsëri paratë.

PËR INFORMACION: Nëse investimi ka qenë pozitiv, do të keni paratë e investuara plus fitimin (rendiment pozitiv), por nëse ka qenë negativ ju do të merrni më pak para nga sa janë derdhur.

Qëllimi i Kredisë

Nëse keni nevojë për një makinë, ju duhet të udhëtoni, të blini librat e shkollës për fëmijët, mobilet për shtëpi, elektro-shtëpiaket ose produkte elektronike dhe nuk i keni menjëherë paratë, mund të kërkonti në dyqan apo direkt në bankë për një kredi (financim) “me qëllim”, pra një kredi të caktuar për të blerë pikërisht atë produkt.

Me këtë lloj kredie, mund të merrni menjëherë paratë që ju duhen për blerjen dhe ta shlyeni me këste, zakonisht çdo muaj. Banka jep hua pas verifikimit të pozicionit të konsumatorit dhe aftësisë së tij për ta shlyer.

Këstet për të paguar shumën e kredisë mund të jenë fikse ose të ndryshueshme, sipas një plani të që përcaktohet në marrëveshje me bankën. Në bazë të shumës dhe kohëzgjatjes së kredisë dhe vlerësimeve të bankës, mund të jetë e nevojshme të jepni garanci për të siguruar shumën që ju duhet.

VINI RE: Nëse dëshironi të blini diçka me këste, mos shikoni vetëm sasinë e këstit që duhet të paguani, por bëni kujdes sidomos me TAEG (Norma e Përqindjes Vjetore), që ju bën të kuptoni se sa paguani interes dhe shpenzime.



Kredi për biznesin

Bankat mund të japin para për shtetasit e huaj që vendosin të fillojnë një biznes vetëpunësimi ose të hapin një biznes të vetin në Itali.

Ato mund t'ju ndihmojnë të zgjidhni llogarinë bankare dhe kredinë më të përshtatshme për veprimtarinë që ju zhvillonin ose dëshironin të zhvillonin.

Analizojnë së bashku me ju për sa keni nevojë për të bërë çfarë dhe në sa kohë do të mund të shlyeni kredinë.

Nëse ju tashmë keni një kompani, do të shqyrtoni së bashku se sa herë keni përdorur tashmë shërbimet bankare dhe garancitë e kërkuara nga banka juaj.

Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit www.pattichiari.it/home/saperne-di-piu/risorse/tutti-gli-argomenti/speciale-migranti/index_ita.dot, dhe shkarko udhëzuesin Emigrantët sipërmarrës.

Kredi personale

Mund të kontaktoni bankën tuaj nëse keni nevojë për të holla për shpenzimet e përditshme të tilla si faturat, shpenzimet mjekësore, taksat dhe librat shkollore, ose për nevoja të paparashikuara.

Për të kërkuar një kredi personale, banka do të kërkojë disa dokumente:

- kartën e identitetit ose pasaportën, ose dokumentin e udhëtimit për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare
- kodin tatimor
- lejen e qëndrimit
- kontratën e punësimit.

Sa kushton? Për të shlyer kredinë në bankë, do të paguani periodikisht (zakonisht çdo muaj) një sasi (zakonisht të caktuar), e cila përfshin një pjesë të shlyerjes dhe të interesit. Gjithmonë shikoni TAEG (Norma Vjetore e Përqindjes), që ju bën të kuptoni se sa paguani përveç parave të marra hua, interesat dhe shpenzimet.

RID

RID do të thotë Raport Ndër-bankar i Drejtpërdrejtë. Në gjuhën e përditshme, është quajtur pastrimi ose ngarkimi automatik në llogari. Praktikisht, me RID banka paguan për ju automatikisht sa herë që ka një kërkesë nga një person ose një entitet që ju keni miratuar më parë dhe do të ngarkojë pagesën në llogarinë tuaj bankare.

Pra RID është i përshtatshëm për të gjitha llojet e pagesave që përsëriten me kalimin e kohës: normat e një kredie ose të hipotekës, faturat elektrike, të ujit, gazit, telefonit. Nuk duhet të rrinin më në radhë në bankë ose në postë dhe është e sigurt se do të paguani në kohë, madje edhe kur jeni me pushime apo jashtë vendit.

Sa kushton? RID është i përshtatshëm: në shumë banka është falas, megjithatë, në përgjithësi kosto është e ulët.



VINI RE: Kur ju kërkohet të aktivizoni një RID është e rëndësishme të mbani gjithmonë nën kontroll bilancin e llogarisë suaj, për të qenë të sigurt se keni para për të paguar shumën e e kërkuar.

Remitanca (Dërgim parash)

Me remitancat mund të dërgoni para nga Italia në vendin tuaj.

Në bankë, mund të bëni një dërgesë me kartë bankare ose kartë krediti, dy mjete këto shumë të sigurta. Sa kushton? Kostoja e remitancave (dërgesave) ndryshon nga banka në bankë.

Pyesni më parë në bankën tuaj ose shkoni në faqen e internetit www.mandasoldiacasa.it, ku ju mund të krahasoni shpenzimet e dërgimit të remitancave të bankave dhe operatorëve të tjerë italianë. Dërgesa është më pak e shtrenjtë në bankë krahasuar me operatorët e tjerë; nëse duhet të dërgoni të holla në një vend shumë të izoluar, ose me shumë urgjencë, disa banka ofrojnë shërbime të Transferimit të Parave, por në përgjithësi ky shërbim kushton më shumë.

PËR INFORMACION: Përveç shpenzimeve, edhe koha e arritjes së parave në vend mbërritje ndryshon nga banka në bankë.

Shërbimi bankar bazë

Ky shërbim është si një llogari bankare dhe është për ata që kanë kërkesa bankare të thjeshta si depozitimi, tërheqja e parave, akreditimi i rrogës, pajisja me kartën e ATM-së. Ashtu si Llogaria Rrjedhëse “Thjesht” nuk parashikon kartat e kreditit dhe bllokun e çeqeve, apo format e kredisë a të investimeve të menjëhershme. Ky shërbim është i ofruar nga bankat pjesëmarrëse në Patti Chiari (www.pattichiari.it).

Sa kushton? Kostoja ndryshon nga banka në bankë, por në përgjithësi është shumë e ulët.

Keni një problem me një bankë?

Nëse ka një gabim ose ka një problem me një bankë (edhe në qoftë se nuk është banka juaj) dhe nuk mund ta zgjidhni atë duke ju drejtuar degës ose Qendrës së Thirrjeve, mund të shkruani në zyrën e ankesave të bankës e cila do t’ju japë përgjigjet. Në qoftë se nuk jeni të kënaqur me përgjigjet, mund t’i drejtoheni Avokatit të Popullit i Bankave dhe Financave ose Ombudsman.

Nëse mendoni se keni pasur një trajtim diskriminues mund të kontaktoni tek UNAR (Zyra e Diskriminimit Racor Kombëtar) duke telefonuar në numrin pa pagesë 800 901010 ose në faqen e internetit: www.unar.it.

Cosa mi serve per pagare l'affitto, le bollette e le tasse?

Come posso inviare denaro ai miei familiari?

Come chiedere un mutuo per comprare casa in Italia?

Queste sono alcune delle domande che si pongono gli stranieri in Italia.

Le risposte si trovano in questa brochure, realizzata da

ABI, in collaborazione con **ACLI**, **ANCI**, **ARCI**, **CARITAS ITALIANA**,
CeSPI, **CISS** e **UNHCR**

per permettere a tutti gli stranieri di avere una vita più semplice
e fare progetti per il proprio futuro.